# DËSHMI ARKIVI

**A-442638**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Trafikanti shqiptar i drogës i shpëton burgut në Britani: E dashura ime vuan nga depresioni |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1391510.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 09:55:23 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 14 shtator 2026, 09:53:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 14 shtator 2026, 09:52:00 UTC → 14 shtator 2026, 09:54:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0525a3428c0e821404b0ca756086197ab3a3edfd7b766fd2873f4053f779288b` |
| TEKSTI | `f7e25e38d7b7171fbc4a05336df536ccc585f3b82241f1d1dbc2629f40899b7b` |
| PAMJA | `d064dad5d733a13ce1882e9e5de1d4cd1a3d7da2b8e92095236250a24fae964d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `068f7259bf6e6435dce6e159982e5f73e27cbf3129cb925409a048061824627e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e4ff47e3158deeff08239dfd88de708dba9085a414711b421c21bd29dcd303ca` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/068f7259bf6e6435dce6e159982e5f73e27cbf3129cb925409a048061824627e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Trafikanti shqiptar i drogës i shpëton burgut në Britani: E dashura ime vuan nga depresioni

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 14.09.2026, 11:53

Share Share



Urim Morina, 27 vjeç, me origjinë shqiptare, i ka shpëtuar burgimit në Britani, pasi gjyqtari mori në konsideratë rrethanat familjare dhe krizën e mbipopullimit në burgje. Morina, i cili kishte hyrë në Mbretërinë e Bashkuar rreth 10 vite më parë me identitet të rremë, u deklarua fajtor për furnizim me kokainë përmes një bande që vepronte në kufijtë e qarqeve, gjatë periudhës shtator 2024–mars 2026, si dhe për posedim të një dokumenti me emër të rremë.

Sipas mediave britanike, ai u dënua me dy masa burgimi, me një total prej dy vitesh e katër muajsh, por gjyqtari James Bromige, në Gjykatën e Kurorës në Winchester, vendosi pezullimin e dënimit për tre vjet. Vendimi u mbështet edhe në udhëzimet e reja të qeverisë britanike për të lehtësuar mbipopullimin e burgjeve, të cilat u lejojnë gjyqtarëve të pezullojnë dënime deri në tre vjet, nga dy vite që ishte kufiri i mëparshëm.

Në vendimin e tij, gjyqtari mori parasysh edhe ndikimin që burgosja e Morinës do të kishte te partnerja e tij, e cila vuan nga depresioni dhe fibromialgjia, një sëmundje kronike që shkakton dhimbje dhe lodhje. Gjykata dëgjoi se Morina kujdesej për familjen, duke gatuar e pastruar dhe duke shoqëruar partneren në vizitat mjekësore.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME

## Më të fundit




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.